**KËRKESË**
**Nr. 57/19, datë 16.7.2025**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 231, datë 17.4.2019, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi i segmentit rrugor 'Pallati me Shigjeta – rrethrrotullimi 'Shqiponja'''.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, ku për pasuritë e llojit "truall" është bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,127,735.40 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë dyzet) lekë (me efekt financiar zbritës prej 10,801,774.0 lekë i vlerës së miratuar me VKM-në nr. 231/2019, i ndryshuar.)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Kastriot Gurra**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR DISA NDRYSHIME NË VKM NR. 231, DATË 17.4.2019, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR "PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI "SHQIPONJA", I NDRYSHUAR

| | Të dhënat sipas VKM nr. 463, datë 10.06.2020 | | | | | | | | | | | | Të dhënat pas ndryshimit | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | TOKË TRUALL | | | | | | | | | | | TOKË TRUALL | | | |
| Nr. | Nr. rendor në VKM nr. 463/2020 | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Sip. totale m² | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja e shpr. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera lekë | VLERA Totale (LEKË) | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona kadastral | Numri i pasu | Sip. total | Lloji i pasu | Sipërfaqja e | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | VLERA Totale (LEKË) |
| 1 | 18 | Bp Lika,Velo,Sulstarova etj. | | | 8310 | 12/139 | 882 | Truall | 862.6 | 31,219.00 | 26,929,509.40 | 26,929,509.40 | Alida<br>KONTAKT SHPK | Haki | Maçi | 8310 | 12/309 | 536 | Truall | 463.5 | 31,219.00 | 14,470,006.50 | 14,470,006.50 |
| | | | | | | | | | | | | | Autoriteti Rrugor Shqiptar | | | 8310 | 12/308 | 346 | Truall | 346 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2 | | | | | | | | | | | | | Ingrid<br>Emi<br>Dolorez<br>Vasil<br>Shaqir<br>Emiljan<br>Haxhi<br>Miçelo | Andrea<br>Andrea<br>Muhamet<br>Thanail<br>Muharrem<br>Dhimitër<br>Shyqyri<br>Ilia | Furxhi<br>Furxhi<br>Furxhi<br>Shallo<br>Shutina<br>Muço<br>Balla<br>Baco | 8310 | 12/145 | 53.1 | Truall | 53.1 | 31,219.00 | 1,657,728.90 | 1,657,728.90 |

Efekti financiar për këtë ndryshim, është me efekt zbritës në shumën 10,801,774 lekë.

Shënime:

- Nëpërmjet kësaj kërkese për shpronësim, kërkohet saktësimi i të dhënave për shpronësim për pasurinë pronë private nr. 12/139, të shpronësuar sipas VKM-së nr. 231, datë 17.4.2019 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i segmentit rrugor "Pallati me Shigjeta – rrethrrotullimi "Shqiponja", i ndryshuar, konkretisht me VKM-në nr. 463/2020, pasi sipas gjurmës së shpronësimi pasuria nr. 12/139 preket faktikisht vetëm për sipërfaqen prej 809.5 $m^2$.
- Sipërfaqja prej 53.1 $m^2$ i përkon pasurisë nr. 12/145 ZK 8310, e cila i shtohet tabelës së miratuar me VKM-në nr. 463/2020.
- Gjithashtu, shpjegojmë se nga verifikimi i dokumentacionit kadastral rezulton se pasuria nr. 12/139 është ndarë dhe ka vijuar në pasuritë nr. 12/309 me sip. totale 536 $m^2$, në pronësi të Alida Maçi dhe Kontakt sh.p.k. dhe nr. 12/308 $m^2$ me sip.346 $m^2$ në pronësi të ARRSH-së.